



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje më nenin 1 pika 10 të Ligjit nr.2002/XX për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, më qëllim të funksionimit efikas dhe të drejtë të strukturave organizative të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, **Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerr këtë:**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 8/2004**  
**PËR VERIFIKIMIN E GJENDJES MATRIALE NË FAMILJET**  
**QË APLIKOJNË PËR NDIHMË SOCIALE**

**Neni 1**

**Qëllimi i udhëzimit administrativ**

- 1.1** Qëllimi i këtij Udhëzimi është verifikimi i të hyrave , dhe të mirave matriale të llogaritshme dhe të pallogaritshme, në familjet që aplikojnë për ndihmë sociale. Verifikimi i gjendjes matriale shërben për vlerësimin e kriterëve financiarë, për llogaritjen e shumës neto të ndihmës sociale që duhet të paguhet.
- 1.2** Në rast se paraqitësi i kërkesës është **kujdestar ligjor i familjes**, por nuk jeton me atë familje, atëherë do të merren parasysh të hyrat e llogaritshme dhe të pallogaritshme të familjes dhe bashkësisë familjare.

**Neni 2**

- 2.1** Çdo paraqitës i kërkesës që aplikon për ndihmë sociale është i obliguar, që në fletëkërkesë të deklarojë të mirat matriale që i posedon dhe të hyrat e familjes.

**Neni 3**

- 3.1** Paraqitësi i kërkesës që aplikon për ndihmë sociale, është i obliguar që fletëkërkesës t'ia bashkangjesë edhe dokumentet përkatëse:
- 3.2** Certifikatën e Kadastrës për sipërfaqen e tokës së paraqitësit të kërkesës, dhe të gjithë anëtarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më të vjetër, këtu duhet të përfshihen gjithashtu të dhënat për prindërit të vdekur dhe të kujdestarëve.

- 3.3** Dokumentet e Taksave, Regjistrimit dhe Sigurimit për automjetin motorik, që shfrytëzohet vetëm nga familja për qëllime shtëpiake, e jo për të krijuar të ardhura.
- 3.4** Certifikatën nga organi përkatës Komunal për lartësinë e Tatimit mbi Pronën.
- 3.5** “Deklaratën e Papunësisë,, e cila definohet si certifikatë zyrtare, ku thuhet se personi i paraqitur, është regjistruar si punëkërkues dhe se është duke kërkuar punë, dhe se kjo certifikatë është lëshuar nga ndonjë Zyrë e Punësimit të Departamentit të Punës së MPMS-së.
- 3.6** Deklaratën e papunësisë për paraqitësin e kërkesës dhe të gjithë anëtarëve të familjes që i përkasin moshës prej tetëmbëdhjetë (18) deri në gjashtëdhjetëepesë (65) vjeç dhe janë të aftë për punë.
- 3.7** Deklaratën e papunësisë për anëtarët e familjes, që i përkasin grup-moshës prej pesëmbëdhjetë (15) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç, dhe nuk e vijnë rregullisht shkollimin.

#### **Neni 4**

- 4.1** Për t’ a gëzuar të drejtën për ndihmë sociale, paraqitësi i kërkesës duhet t’i plotësojë kriteret financiare dhe kriteret jo financiare.

#### **Neni 5**

- 5.1** Paraqitësi i kërkesës për ndihmë Sociale, duhet t’i nënshtrohet procedurës së verifikimit të gjendjes materiale. Verifikimi në terren bëhet nga nënpunësit përgjegjës të Qendrës për Punë Sociale.

#### **Neni 6**

- 6.1** Procedurën e verifikimit të gjendjes materiale për paraqitësin e kërkesës, duke u bazuar në Dispozitat e Rregullores zbatuse nr.2003/XX, për zbatimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale, përbëhet prej dy pjesëve:
- 1.** Procedurën e verifikimit të të mirave materiale dhe
  - 2.** Procedurën e verifikimit të të hyrave materiale

#### **Neni 7**

- 7.1** Të mirat materiale mund të jenë të llogaritshme dhe të pallogaritshme.

#### **Neni 8**

- 8.1** Metoda e vlerësimit të të mirave materiale të llogaritshme do të bëhet në këtë mënyrë: vlera e shumës së përgjithshme të pagesës së përgjithshme, do të pjestohet me 6, për t’ a përfituar vlerën neto të vlerës mujore (periudha prej 6 muajve është periudha maksimale për pagesën e kërkesës për ndihmë sociale).

## **Neni 9**

**9.1** Të hyrat mund të jenë të llogaritshme dhe të pallogaritshme.

## **Neni 10**

**10.1** Metoda e vlerësimit të të hyrave matriale do të bëhet siç vijon; vlera e shumës së përgjithëshme të të hyrave të llogaritshme do të ndahet ose pjestohet më 6, për t'a përfituar vlerën neto të vlerës mujore (periudha prej 6 muajve është periudha maksimale për pagesën e kërkesës për ndihmë sociale ).

## **Neni 11**

**11.1.** Çdo paraqitës i kërkesës për ndihmë sociale, pas dorëzimit të dokumentacionit në Qendrën për Punë Sociale, duhet të verifikohet nga nënpunësit e Qendrës për Punë Sociale përkatëse, dhe t'i jepet vendimi brenda 45 ditësh prej dorëzimit të fletkërkesës në Qendrën për pune Sociale.

**11.2.** Verifikimi ka të bëjë me verifikimin e deklaratës për të mirat dhe të hyrat e deklaruara, nga paraqitësi i kërkesës në fletkërkesë dhe dokumentacion me gjendjen reale në terren.

## **Neni 12**

**12.1.** Në mënyrë që verifikimi i gjendjes matriale të jëtë më efikas, gjithsesi duhet të mundësohet bashkëpunimi në mes të QPS-ve dhe organeve përkatëse komunale, në përcaktimin e formave të nevojshme për prezantimin real të të mirave matriale që i posedon familja.

**12.2.** Për identifikimin e saktë të tatimit duhet të mundësohet përpilimi i formës së dokumentit për lartësinë e tatimit mbi pronën, për familjet që aplikojnë për ndihma sociale.

**12.3.** Gjithashtu, për identifikimin e saktë të sipërfaqes së tokës duhet të mundësohet përpilimi i formës së dokumentit për pronësinë e tokës për familjet që aplikojnë për ndihma sociale.

## **Neni 13**

**13.1.** Në mënyrë që verifikimi i të hyrave të familjes të jëtë më i saktë duhet, të mundësohet krahasimi i të dhënave të familjeve që aplikojnë për ndihma sociale me të dhënat e organeve të tjera kompetente.

**13.2.** Krahasimi i të dhënave të familjeve që aplikojnë për ndihma sociale bëhet me:

- të dhënat e Ministrisë së Shërbimeve Publike përkatësisht, me të dhënat e mekanizmave implementuese të kësaj Ministrie.
- të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Administratën Tatimore)
- të dhënat me Qendrat Regjionale të regjistrimit të automjeteve.

#### **Neni 14**

- 14.1** Në rast nevoje MPMS-ja përkatësisht Qendra për Punë Sociale, mund të kërkojë edhe dokumentacion plotësues, për verifikimin e gjendjes matriale të familjeve të cilat aplikojnë për ndihma sociale.

#### **Neni 15**

- 15.1** MPMS-ja nëse e shih të nevojshme mund të caktojë lloje të tjera të të hyrave të llogaritshme, që do të merren parasysh për verifikimin e gjendjes materiale të familjeve që paraqesin kërkesë për ndihma sociale.

#### **Neni 16**

- 16.1** Për aplikimin e drejtë të dispozitave ligjore MPMS-ja bën kontroll dhe Inspektim të familjeve, shfrytëzuse të ndihmave sociale, me qëllim të sigurimit të saktësisë në pagesa, vendimeve korrekte dhe parandalimit të mashtrimeve dhe korrupsionit eventual.

#### **Neni 17**

- 17.1** Çdo paraqitës i kërkesës që më vetëdije deklaron të dhëna të pavërteta ose prezanton dokumente të pasakta për të përfituar ndihmën sociale, duke përfshirë këtu edhe ato që kanë të bëjnë më verifikimin e gjendjes matriale do të sanksionohet sipas Ligjit të Skemës për Ndihmë Sociale neni 10 pika 1 dhe 2.

#### **Neni 18**

- 18.1** Ky Udhëzim Administrativ, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

**Prishtinë, Mars 2004**

**Ministri i MPMS-së  
Ahmet Isufi**

---

